



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE**  
**DREJTORIA JURIDIKE**  
**NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. \_\_\_\_\_prot.

Vlorë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_2024

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT**

**Data 04.12.2024**

**Drejtuar:** "FLED" shpk me Nr.Nipt K17621104C

**Operatorit Ekonomik (OE)**  **ose**

"FLED" shpk me Nr.Nipt K17621104C

*Adresa: Berat Kozare HAVALEHAS Lagjja" Havaleas", rruga Ura e kozares Kuçovë, godinë private 1- katëshe, Nr.307*

**Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE)**

*[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]*

**- OE/BOE me nënkontraktor**

**PO**  **JO**

**-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:**

**PO**  **JO**

*Nëse po, të jepen dhënat:*

"Desaret Company" shpk me Nr. Nipt K01816001J

*Adresa: TIRANE, Njesia Bashkiake nr 11, Rruga "Hysni Gerbolli", Pallati "Desaret", Prane Kryqit te Kuq, Kati perdhe.*

Tipi i Kontratës: **Punë**

Lloji i Procedurës së prokurimit: **Procedurë e hapur**

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: **REF-25481-10-18-2024**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “**Barriera metalike mbrojtëse për këmbësorët përgjatë rrugës “Transballkanike” dhe rrugës “Ali Demi”**”

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: **60 (gjashtëdhjetë) ditë pune nga nënshkrimi i kontratës;**

Data e Publikimit në SPE të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: **26.11.2024**

<sup>1</sup>Data e Publikimit në Buletinin e Njoftimeve Publike të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit **Buletini Nr. 83 datë 2 Dhjetor 2024**

#### **KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:**

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **X**

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

#### **1. AVDULI shpk**

*Emri i plotë i shoqërisë*

**Nipt J66703306O**

*Numri i NIPT-t*

Vlera e ofertës **18,101,348.00 (tetëmbëdhjetë milion e njëqind e një mijë e treqind e dyzetë e tetë) Lekë pa TVSH.**

*(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO **X**

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

#### **2. FLED shpk**

*Emri i plotë i shoqërisë*

**Nipt K17621104C**

*Numri i NIPT-it*

Vlera e ofertës **20,416,300.00 (njëzet milion e katërqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e treqind) Lekë pa TVSH.**

*(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

OE/BOE me nënkontraktor

PO **X** JO

“Desaret Company” shpk me Nr. Nipt K01816001J (operator ekonomik mbështetës)

#### **3. KOLOSEU shpk**

**Nipt J72603129H**

<sup>1</sup> Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, plotësohet vetëm data e publikimit të këtyre njoftimeve në BNJP

Vlera e ofertës **22,118,802.00 (njëzet e dy milion e njëqind e tetëmbëdhjetë mijë e tetëqind e dy) Lekë pa TVSH.**

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar **2 (dy) ofertues.**

**1. AVDULI shpk**

**Nipt J667033060**

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-t*

*arsyet e mëposhtme*

Nga komisioni i vlerësimit të ofertave referuar *Nenit 77, Nenit 80 dhe Nenit 82 të LPP*, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në këtë procedurë prokurimi rezulton se operatori ekonomik, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të dokumentave standarte të tenderit ka deklaruar se disponon mjete dhe punonjës të cilët i ka deklaruar dhe në procedurën e prokurimit “Rikonstruksioni i rrugës së fshatit “Drithas” për të cilën ka lidhur kontratë me Autoritetin Kontraktor Bashkia Vlorë.

Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përkrahura, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak s’kualifikimi.

Operatori Ekonomik ka nënshkruar *Deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata Të Tjera*, pra Operatori Ekonomik i shpallur fitues në procedurën “Barriera metalike mbrojtëse për këmbësorët përgjatë rrugës “Transballkanike” dhe rrugës “Ali Demi” sepse bie ndesh me kushtin për mosangazhimin e mjeteve dhe punonjësve në Kontrata të tjera. Grafikët për kryerjen e punimeve në të dyja procedurat kërkojnë angazhimin të plotë dhe të njëkohshëm të mjeteve dhe punonjësve në të dyja procedurat, për këto arsye KVO **e shpall të pavlefshme këtë ofertë.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

**2. KOLOSEU shpk**

**Nipt J72603129H**

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-t*

*arsyet e mëposhtme*

Nga komisioni i vlerësimit të ofertave referuar *Nenit 77, Nenit 80 dhe Nenit 82 të LPP*, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në këtë procedurë prokurimi rezulton se operatori ekonomik nuk plotëson kriteret në pikat:

- Mungon **shtojca 3**, formulari i sigurimit të ofertës. Operatori nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës.

- Nuk plotëson pikën **2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në bazë të VKM – së Nr. 42, datë 16.01.2008, i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë N.P – 1 A, NP – 4 A, NS – 8 B.** Operatori ekonomik nuk ka paraqitur licencat e kërkuara.
- Nuk plotëson pikën **2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar...,** pasi në formularin përmbledhës të vetdeklarimit operatori ekonomik nuk ka paraqitur punonjësit.
- Nuk plotëson pikën **2.3.6 Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se kanë të punësuar në stafin e tyre 1 (një) punonjës i pajisur me certifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” dhe b) 1 (një) punonjës i cili të plotësojë kërkesat dhe të disponojë certifikatën si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë”,** në formularin përmbledhës të vetdeklarimit operatori ekonomik nuk ka paraqitur punonjësit, për këto arsye KVO **e shpall të pavlefshme këtë ofertë.**

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **FLED shpk me Nipt K17621104C** me adresë *Berat Kozare HAVALEHAS Lagjja" Havaleas", rruga Ura e kozares Kuçovë, godinë private 1- katëshe, Nr.307,* se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **20,416,300.00 (njëzet milion e katërqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e treqind) lekë pa TVSH [shuma përkatëse e shprehur me fjalë dhe shifra]** / totali i pikëve të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si oferta fituese.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Bashkisë Vlorë* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë ) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Nese nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të parashikuar në dokumentet e tenderit, apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do t’ju konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

PO  JO X

Nëse Po ( Nr. \_\_ Datë \_\_ i vendimit përfundimtar për shqyrtimin e ankesës, të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik)

**KRYETAR**  
**Ermal Dredha**

**ME URDHËR DELEGIMI**  
**NËNKRYETAR**

**Klevis Kaso**